

Shtojca 12.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

Data: 24/09/2025

Drejtuar: BOE “RESTAURIM GURRA-KACA” Sh.P.K me adrese: Zona Industriale, Ish Ndermarja e Ndertimit, zona kadastrale 2446, numri pasurise 1/564, Librazhd dhe NIPT : K87706601M & “VIANTE Konstruksion” SHPK me adrese : Elbasan Gramsh GRAMSH SPORTI dhe NIPT: K47103804L ;

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

Tipi i Kontratës: Pune

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

**Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Sistemim asfaltim i rruges Mirake - Plane ,
Mirake-Katund faza e I-re njesia Administrative Polis Bashkia Librazhd.”**

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF: 59248-08-27-2025

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 4 muaj

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 28/08/2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 47 datë 1 Shtator 2025

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “2Z KONSTRUKSION” sh.p.k

J63229466K

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 24,709,145 (Njete e kater milion e shtateqinde e nente mije e njeqinde e dyzete e pese) Lekë pa Tvsh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO x

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. BOE “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k.

L41513008A

&

&

“BE-IS sh.p.k.

K71412003A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 23,724,372.02 (njete e tre milion e shtateqind e njete e kater mije e treqind e shtatedhete e dy pike zero dy) leke pa tvsh .

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO x

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. OE "L.T.E CONSTRUCTION" SH.P.K

L78006801F

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 22,453,984.20 (*Njezete e dy milion e katerqind e pesedhjetë e tre mijë e nentëqind e tetëdhjetë e kater pike dy)leke pa tvsh.*

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. BOE "RESTAURIM GURRA-KACA" Sh.P.K.

K87706601M

&

&

"VIANTE Konstruktion" SHPK

K47103804L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 24,239,832.41 (*Njezete e kater milion e dyqind e tridhjetë e nente mijë e teteqind e tridhjetë e dy pike dyzete e nje) lekë pa TVSH .*

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori Ekonomik OE “L.T.E CONSTRUCTION” SH.P.K NIPT; L78006801F per arsye se :

I. SKUALIFIKIMIN E OPERATORIT EKONOMIK “L.T.E CONSTRUCTION” SH.P.K PER SHKAK SE :

Nga shqyrtimi i dokumentacionit kualifikues për **Operatorin Ekonomik L.T.E CONSTRUCTION sh.p.k** ne mbështetje te nenit 80 dhe nenit 92, pika 3 e ligjit nr. 162, date 23.12.2020, per “Prokurimin Publik”, ne baze te nenit 82, te VKM nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarte te tenderit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se:

“L.T.E CONSTRUCTION sh.p.k nuk ka arritur te paraqesin dokumentacion te plote e te sakte per te deshmuar plotesimin e Kriteve te Vecanta per Kualifikim

Konkretisht:

1.1 Mbështetja në kapacitetet e subjekteve mbështetëse është bërë në tejkalim të kufijve të lejuar prej 50% të përcaktuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar, neni 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, pika 2, ku sahpërehimisht eshte percaktuar :

“[...] Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor [...].”

Kështu:

a.Në pikën 2.3.7 të KVK-së, ndër të tjera, është kërkuar vetëdeklarimi i disponimit të së paku tre specialistëve/punëtorëve për punime asfaltimi në rrugë.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ka vetëdeklaruar mbështetjen në kapacitete të një subjekti tjetër, “VARAKU E” sh.p.k., për te tre punëtorët e asfaltimit.

Pra, nga tre specialistët/punëtorët e kërkuar për këtë profesion, të tre i ka vetëdeklaruar se do t'i marrë me mbështetje nga një operator tjetër. Kjo vjen në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2 të nenit 90 të VKM nr. 285/2021, prandaj ky kriter konsiderohet i papërmbushur, në përputhje me përcaktimet e rregullave të prokurimit në fuqi.

b. Në pikën 2.3.8 të KVK-së është kërkuar:

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi 3 (tre) shoferë të mjeteve të rënda/kamioni dhe 4 (katër) manovratorë (2 automakinistë dhe 2 eskavatoristë), të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë si të punësuar për periudhën e 3 muajve të fundit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, nga tre shoferët e kërkuar, operatori ka vetëdeklaruar dy prej tyre si të marrë me mbështetje, ndërsa vetëm për një ka vetëdeklaruar që e ka të punësuar vetë.

Nga dy eskavatoristët e kërkuar, të dy janë vetëdeklaruar si të marrë me mbështetje nga një operator tjetër.

Numri i drejtuesve të mjeteve të rënda (shoferë dhe eskavatoristë) të vetëdeklaruar si me mbështetje është më shumë se 50% e numrit të kërkuar në DST. Kjo bie në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2 të nenit 90 të VKM nr. 285/2021.

Për këtë arsye, kriteri konsiderohet i papërmbushur, në përputhje me rregullat e prokurimit në fuqi.

Në këtë rast, KVO-ja i referohet praktikës së vendimmarrjeve të Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), si p.sh. Vendimi nr. 256/2025, datë 19.02.2025, ku subjekti ankimues është rrëzuar me arsyetimin se:

“Në pikën 4 të nenit 90 të aktit nënligjor të sipërpërmendur është përcaktuar që: ‘4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.’”

Për këtë arsye, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “INERTI” sh.p.k. është konsideruar i pabazuar dhe është rrëzuar..

1.2 Formulari i Vetëdeklarimit (Shtojca 8) i operatorit ekonomik përmban pasaktësi që shkaktojnë konfuzion tek KVO-ja.

Më konkretisht, në:

- Pjesa I, A: Informacion në lidhje me operatorin ekonomik, operatori ka vetëdeklaruar se paraqet ofertë si Bashkim Operatorësh Ekonomik (BOE), dhe subjektin “Varaku E” sh.p.k. e ka deklaruar si anëtar të BOE-së;

- Ndërsa në rubrikën B: Deklaratë, të njëjtin subjekt, “Varaku E” sh.p.k., e ka vetëdeklaruar si subjekt mbështetës.

Ky vetëdeklarim kontradiktor krijon konfuzion dhe paqartësi për KVO-në, pasi i njëjti operator është paraqitur si anëtar i BOE-së (pa kontratë bashkëpunimi të dorëzuar), por njëkohësisht edhe si subjekt mbështetës.

Sipas Shtojcës 7 të DST-së, është parashikuar qartë se:

“Rastet e paraqitjes së dokumenteve të pasakta... konsiderohen kushte për skualifikim.”

Për rrjedhojë, kjo pasaktësi bie ndesh me kërkesat e dokumentacionit të tenderit dhe përbën shkak për skualifikim.

1.3 Operatorit nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të saktë për të dëshmuar përmbushjen e pikës 2.3.12.a të KVK-së.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik ka paraqitur një licencë të lëshuar nga QKB, me kodin 1.2.A, e cila ka si objekt:

“Studimi dhe përgatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave”.

Por, objekti i kontratës që është subjekt i këtij prokurimi lidhet me punime rruge, të cilat nuk përputhen me fushën e mbulimit të licencës së paraqitur nga operatori.

Për rrjedhojë, ky kriter konsiderohet i papërmbushur, në përputhje me kërkesat e DT.

1.4 Operatori nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e pikës 2.3.2 të KVK-së lidhur me disponimin e kategorive të kërkuara të licencës në nivelin e përcaktuar në Dokumentet e Tenderit.

Kjo sepse ;

Për kategoritë NS-6, NS-9 dhe NS-10, operatori ka vetëdeklaruar mbështetje në kapacitetet e licencës së subjektit Varaku E sh.p.k.

Ligji për Prokurimin Publik dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, parashikojnë mundësinë që një operator ekonomik të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duke përcaktuar qartë mënyrat dhe kushtet e kësaj mbështetjeje.

Në Dokumentet e Tenderit (DT) te kesaj procedure nuk është bërë ndonjë kufizim specifik në lidhje me ndonjë aspekt të kapaciteteve për të cilat nuk lejohet mbështetja, duke krijuar perceptimin se, në mungesë kufizimesh, operatori mund të mbështetet për çdo lloj kapaciteti të kërkuar.

Megjithatë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) nuk mund të anashkalojë ligjin sektorial përkatës, i cili, sipas praktikës së konsoliduar të vendimmarrjeve të Komisionit të Prokurimit Publik dhe jurisprudencës përkatëse të gjykatave shqiptare, prevalon ndaj dispozitave të përgjithshme të Ligjit për Prokurimin Publik.

Më konkretisht..

Në ligjin nr. **8402, datë 10.09.1998** “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, në nenin 8, pika 1 përcaktohet qartë se:

“Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendës apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimore.”

Gjithashtu, sipas **VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008**, në kreun III, lidhur me kategorizimin dhe klasifikimin e licencave ndërtimore, theksohet se:

> “Licenca është dokument juridik dhe profesional që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar ndërtimore, sipas

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- *profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.*

II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente:

- *Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri;*

- *Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë;*

- *Kapacitetet financiare*

Për më tepër, në VKM nr. 448, datë 31.07.2025, "Për miratimin e Rregullores së Zbatimit të Punimeve të Ndërtimit dhe të Rregullave të Kantierit", në nenin 6, përcaktohet se:

> “Çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi vetëm për kategoritë e punimeve që ka të përcaktuara në licencë.”

Në të njëjtën linjë, neni 7 i së njëjtës VKM, thekson se:

> “Zbatuesi i punimeve duhet të jetë vetë i licencuar për veprimtarinë përkatëse.”

Nga interpretimi i dispozitave ligjore sektoriale që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë ndërtimore, del qartë dhe pa ekuivok se një subjekt juridik nuk mund të zbatojë apo realizojë punime ndërtimi jashtë kategorive dhe nivelit që ka të përcaktuar në licencën e tij, të lëshuar nga Ministria përgjegjëse për zhvillimin e territorit (aktualisht MIE).

Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998, si dhe VKM nr. 42/2008, përcaktojnë qartësisht se kategoritë e licencës nuk janë të transferueshme apo të “huazueshme” nga një subjekt në një tjetër. Ato fitohen vetëm nëpërmjet plotësimit të kriterëve të caktuara për përvojë, kapacitete teknike, financiare dhe drejtues teknikë të kualifikuar.

Nuk ekziston asnjë dispozitë ligjore që parashikon mbështetjen në licencën ndërtimore të një subjekti tjetër. Një interpretim i tillë do të sillte në praktikë anashkalimin e rolit të Komisionit të Dhënies së Licencave, që është autoriteti kompetent për verifikimin dhe lëshimin e licencave ndërtimore sipas kategorive të përcaktuara.

Është nonsens ligjor dhe logjik që një kategori licence që një subjekt e ka fituar në bazë të një procedure të rregullt ligjore, të mund të përdoret për llogari të një subjekti tjetër që nuk e ka kaluar këtë filtër institucional dhe ligjor.

Sa i përket legjislacionit të prokurimeve publike, edhe Ligji nr. 162/2020 dhe VKM nr. 285/2021 nuk parashikojnë mundësinë e mbështetjes për kategoritë e licencës për zbatim punimesh ndërtimore. Forma e vetme e lejuar për të bashkuar kapacitetet në kategorite apo nivelin e licences , është krijimi i një Bashkimi Operatorësh Ekonomikë (BOE).

Në këtë rast, për të përmbushur kriterin e licencës përkatëse, operatori do të duhej të lidhte një marrëveshje bashkëpunimi me një subjekt tjetër dhe ta paraqiste ofertën si BOE, duke detajuar në akt-marrëveshje ndarjen e punëve dhe përputhjen me kategorinë e licencës që zotëron secili.

Përfundimisht, mbështetja në kategori licence ndërtimi nga një subjekt tjetër, jashtë një marrëveshjeje BOE, është në kundërshtim me kuadrin ligjor sektorial dhe konsiderohet e papranueshme nga pikëpamja ligjore dhe procedurale.

Nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime nbi vendosjen e këtij kriteri apo paqartësi mbi argumentimin e aplikimit të këtij kriteri ka pasur momentin procedural për të paraqitur ankesë apo kerkese për sqarim pranë AK brenda afateve të përcaktuara në LPP
Në këto kushte kur operatori ekonomik nuk ka ezauruar momentet procedurale për të kundërshtuar kriteret e vendosura ka qënë i detyruar që në fazën e vlerësimit të ofertave të paragesë e disponojr kategorite perkatese e nivelin e pikave te licences te kërkuar në DT.

..Per sa me siper KVO konkludon se operatori nuk ploteson piken 2.3.2 te KVK e duhet te skualifikohet qofte edhe vetem per kete mospermbushje kriteri .

1.5 – Mospërmbushja e pikës 2.3.5.g të KVK-së – Mungesa e mjekut të ndërmarrjes

Operatori ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e pikës 2.3.5.g të KVK-së, e cila kërkon disponimin e mjekut të ndërmarrjes. Në dokumentacionin e paraqitur, vetë operatori ka

pranuar se nuk e ka të punësuar mjekun e ndërmarrjes, dhe për të plotësuar këtë kriter ka vetëdeklaruar mbështetjen në kapacitetet e subjektit tjetër “Varaku E” shpk.

Megjithatë, në këtë rast, operatori duhet t’i referohej dispozitave ligjore specifike që rregullojnë detyrimin e punëdhënësit për sigurimin e shërbimit mjekësor në vendin e punës, sipas legjislacionit sektorial në fuqi, konkretisht:

- Ligji nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurimin shoqëror të detyrueshëm në sektorin privat”,
- Vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, që klasifikojnë ndërmarrjet sipas grupeve dhe përcaktojnë numrin minimal të punonjësve mbi të cilin lind detyrimi për të pasur mjek të punës të brendshëm apo të kontraktuar me kontratë shërbimi. *Ne rregullat e prokurimit përcaktohet qarte se mosplotesimi qofte edhe i nje prej kriterëve per kualifikim perben shkak per skualifikim .*

Duke qenë se operatori ka më shumë se 15 punonjës të deklaruar, ai është i detyruar të ketë mjek të ndërmarrjes, të punësuar ose të kontraktuar përmes marrëveshjeje shërbimi. Ky shërbim nuk mund të merret me “mbështetje” nga një subjekt tjetër, pasi legjislacioni sektorial nuk e njeh konceptin e huazimit të mjekut, përveçse nëpërmjet kontratës së posaçme për ofrimin e këtij shërbimi shëndetësor.

Nëse operatori do të donte të harmonizonte veprimin e tij me legjislacionin në fuqi, duhej të kishte lidhur kontratë shërbimi me mjekun e subjektit mbështetës, dhe jo thjesht të vetëdeklaronte “mbështetje”, që në këtë rast është e paaplikueshme dhe e papajtueshme me bazën ligjore sektoriale, e cila prevalon ndaj dispozitave të përgjithshme të prokurimit publik.

Për rrjedhojë, ky kriter konsiderohet i papërmbyshur.

1.6 OE nuk ka arritur plotesojë kushtet e përcaktuara në nenin 90 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Specifikisht piken 2 të nenit 90.

Neni 90

Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;
- t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.
- **t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.**
- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në

kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

Subjekti mbështetet “VARAKU E” shpk aktualisht është ne kontrate publike pune ne Bashkinë Librazhd. Specifikisht kontraten nr.4033 prot, date 23.08.2024 me objekt “Sistemim asfaltim i rruges Funares-Zdrajsh, Njesia Administrative Orenje, Bashkia Librazhd” amenduar me kontarten nr.4227 prot, date 17.06.2025.

Rezulton nga sistemi i brendshëm i taksave dhe tarifave vendore qe subjekti “VARAKU E” shpk është debitor ne vleren 36,625 leke per taksat dhe tarifat vendore ne Bashkinë Librazhd per shkak se është ne nje kontrate publike ne bashki dhe nuk ka kryer pagesen per periudhen e plote te kontrates publike.

Ne kete rast sipas percaktimeve te nenit 90 te VKM nr.285, date 19.05.2021 duhet **t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.**

Neni 76

Kriteret detyruese për skualifikim

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik **ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave** ose kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Persa me siper bazuar ne parashikimet ligjore te sipercituara OE “L.T.E CONSTRUCTION” SHPK skualifikohet ne kete procedure prokurimi pasi nuk ka arritur **t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.**

Rezulton se subjekti mbështetet “VARAKU E” shpk është debitor dhe nuk ka paguar detyrimet per taksat vendore ne bashkinë Librazhd ndryshe nga cfare ka deklaruar ne formularin permbledhes.

Bashkia Librazhd e verteton ne menyre te thjeshte dhe te shpejte pasi subjekti “VARAKU E” SHPK është ne nje kontrate tjeter ne proces dhe automatikisht ngarkohet me detyrime per taksa dhe tarifa vendore te cilat nuk arritur ti paguaje sipas detyrimit te Ligjit nr.9632, date 20.10.2006 “Per sistemin e taskave vendore” te ndryshuar.

Per sa me siper, mbështetur në nenin 92/3 të LPP-së ku shprehimisht përcaktohet se:

*“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, **KVO vendos te skualifikojë oferten e L.T.E CONSTRUCTION sh.p.k.***

II. SKUALIFIKIMIN E B.O.E. "APIS CONSTRUCTION" sh.p.k. NIPT: L41513008A & "BE-IS sh.p.k. NIPT: K71412003A PER SHKAK SE :

Nga shqyrtimi i dokumentacionit kualifikues për kete **BOE"BE IS " SHPK & "APIS KONSTRUKSION" SHPK**, ne mbeshtetje te nenit 80 dhe nenit 92, pika 3 e ligjit nr. 162, date 23.12.2020, per "Prokurimin Publik", ne baze te nenit 82, te VKM nr. 285, date 19.05.2021, "Per miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarte te tenderit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se:

2.1 Një nga anëtarët e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE), konkretisht operatori "Apis Konstruksion" shpk, nuk ka arritur të vetëdeklarojë apo të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar përmbushjen e çdo kriteri të kualifikimit në përpjesëtim me natyrën dhe përqindjen e punimeve të marra përsipër në akt-marrëveshjen e bashkëpunimit.

Më konkretisht, operatori nuk ka përmbushur pikën 2.3.1 të KVK-së, që lidhet me përvojën e mëparshme të ngjashme:

- Nuk ka paraqitur asnjë kontratë të ngjashme që të përmbushë kërkesën e pikës 2.3.1.a;
- Nuk ka realizuar kontrata të ngjashme në 5 vitet e fundit, siç kërkohet në pikën 2.3.1.b.

Kontratat e paraqitura nga "Apis Konstruksion" shpk nuk janë të natyrës së ngjashme me natyrën e punimeve të marra përsipër në kuadër të kontrates objekt prokurimi, referuar zerave kryesorë të preventivit, si në volum ashtu edhe në vlerë.

Referuar praktikës së konsoliduar të Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), vlerësimi i ngjashmërisë së kontratave nuk bëhet vetëm mbi bazën e titullit të kontratës, por mbi ngjashmerine e punimeve të realizuara me zerat kryesorë të objektit të prokurimit, në raport me peshën e tyre në preventivin përkatës.

Ky operator ka marrë përsipër të realizojë 1500 m² shtresë binderi dhe 1000 m² shtresë asfalti, sipas ndarjes së përcaktuar në akt-marrëveshjen e bashkëpunimit.

Megjithatë, nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se operatori nuk ka asnjë kontratë të mëparshme të ngjashme që të përfshijë këto lloje punimesh.

Nënkontrata e paraqitur me subjektin "Rafin Company" shpk nuk mund të konsiderohet e vlefshme, pasi nuk është lidhur në përputhje me parashikimet e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), duke mos u miratuar nga Autoriteti Kontraktor, konkretisht Bashkia Tiranë.

Bazuar në praktikën e konsoliduar të Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) dhe të Gjykatës Administrative të Tiranës, nënkontratat e lidhura në kundërshtim me kërkesat e LPP dhe me rregullat përkatëse të prokurimit publik trajtohen si të pavlefshme dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit apo zbatimin e kontratës.

Madje ne nje nga keto vendime te KPP konkretisht vendimi nr **747/2015** , ankimes ka qene nje nga anetaret e ketij BOE , operatori BE IS shpk . KPP ne kete vendim ka rrezuar ankesen duke arsyetuar se ;

.....*Në respekt të parimit juridik "Conventio privatorum non potest publico juri derogare" (një marrëveshje e personave private nuk mund të shmangen nga e drejta publike)". Marrëveshja*

konkrete mes palëve për nënkontraktim të punëve publike, do të interpretohet vetëm në bazë lex specialis. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk mund të vlerësojë mbi eksperiencën e mëparshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurë prokurimi, referuar kontratave të lidhura në kundërshtim me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk mund të vlerësojë mbi eksperiencën e mëparshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurë prokurimi, referuar kontratave të lidhura në kundërshtim me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve....

Për rrjedhojë, operatori nuk ka përmbushur detyrimet që i takojnë sipas akt-marrëveshjes së bashkëpunimit, duke bërë që kriteri i përvojës së ngjashme nuk konsiderohet i përmbushur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.1 të KVK-së, në përpjesëtim me natyrën dhe përqindjen e punimeve të marra përsipër në kuadër të ofertës si pjesë e BOE-së.

2.2 Operatori nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të sakte për të deshmuar plotësimin e pikës 2.3.5.a të KVK-së lidhur me disponimin e **1(një)** person, pjese e stafit të shoqërisë, i certifikuar si **Ekspert Zjarrefikes** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.

Kjo, pasi operatori ekonomik “Apis Konstruktion” shpk ka marrë përsipër të realizojë 31.47% të punimeve, dhe sipas preventivit dhe ndarjes së punëve në akt-marrëveshjen e bashkëpunimit, ka marrë përsipër të kryejë % të caktuara në secilin prej zërave të punimeve të parashikuara në preventiv.

Kriteri për disponimin e specialistit të kërkuar në pikën 2.3.5.a është një kriter i aftësisë tekniko-profesionale, dhe si i tillë duhet të plotësohet nga secili anëtar i BOE-së, në përputhje me natyrën dhe përqindjen e punëve të marra përsipër, në zbatim të nenit 88, pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, ku parashikohet se:

> “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt-marrëveshje.”

Mosvetëdeklarimi i specialistit të kërkuar nga operatori “Apis Konstruktion” shpk përbën mosplotësim të kriterit 2.3.5.a, dhe në përputhje me rregullat e prokurimit, kjo konsiderohet shkak për skualifikim.

2.3 Operatori “Apis Konstruktion” shpk ka vetdekluar disponimin e dy muratoreve me deshmë të leshuar nga qendra ReBorn por kjo qender nuk është e akredituar për leshimin e ketyre deshmive referuar kontrollit që u bë www.qkb.gov.al.

Duke qenë se deshmia e kualifikimit të tyre është e pavlefshme sepse është leshuar nga një institucion që nuk ka autoritetin ligjor për ta leshuar atë, atëherë ky kriter pika 2.3.7 rezulton i papërmbushur nga ky operator në proporcion me natyrën dhe % e marre për sipër në akt marrëveshjen e bashkëpunimit

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili përcakton se:

> “Autoriteti ose enti kontraktor [...] vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.”,

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) vendos të skualifikojë ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “BE IS” shpk & “Apis Konstruksion” shpk.

III. SKUALIFIKIMIN E OPERATORIT EKONOMIK “2Z KONSTRUKSION” sh.p.k , NIPT; J63229466K PER SHKAK SE :

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendos të skualifikojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “2Z Konstruksion” shpk, për këto arsye:

3.1. Mungesa e kategorisë së licencës NS6 në nivelin e kërkuar

Operatori nuk disponon kategorinë NS6 të licencës në nivelin e kërkuar në pikën 2.3.2 të Kriterieve për Kualifikim (KVO-së), siç përcaktohet në Dokumentet e Tenderit. Mosplotësimi i kësaj kërkesë përbën shkak të drejtpërdrejtë për skualifikim, pasi lidhet me aftësinë teknike për zbatimin e kontratës.

3.2. Mungesa e licencës I.2A në përputhje me natyrën e punimeve

Gjithashtu, operatori ka paraqitur licencë me kod I.2A, e cila nuk është në përputhje me natyrën e punimeve të kontratës objekt prokurimi, të cilat janë të karakterit ndërtimor dhe kërkojnë licenca për zbatim punimesh ndërtimi në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Kjo përbën mosplotësim të pikës 2.3.12.a të KVK-së, dhe e bën ofertën të papranueshme për vlerësim të mëtejshëm.

3.3 Nuk ka arritur te paarqese dokumentacion per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.9 te KVKse

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili përcakton se:

> “Autoriteti ose enti kontraktor [...] vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.”,

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) vendos të skualifikojë ofertën e 2Z Konstruksion shpk

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE “RESTAURIM GURRA-KACA” Sh.P.K me adrese: Zona Industriale, Ish Ndermarja e Ndertimit, zona kadastrale 2446, numri pasurise 1/564, Librazhd dhe NIPT : K87706601M & “VIANTE Konstruksion” SHPK me adrese : Elbasan Gramsh GRAMSH SPORTI dhe NIPT: K47103804L** , se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **24,239,832.41 (Njezete e kater milion e dyqind e tridhjete e nente mije e teteqind e tridhjete e dy pike dyzete e nje) lekë pa TVSH** / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

PERSONI I AUTORIZUAR I TITULLARIT TË AUTORITETIT KONTRAKTOR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
BAJRAM PISHKASHI